



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 172/5 prot.

Tiranë, më 10.07.2020

VENDIM
Nr.60, datë 10.07.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 11, DATË 10.2.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 11, datë 10.2.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në lidhje me transferimin e përkohshëm të nëpunëses *****”*.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të ardhur nga nëpunësja *****, regjistruar me nr.1728 prot., datë 11.12.2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është njohur me pretendimin se, transferimi i saj i përkohshëm në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Vlerës Doganore”*, në Drejtorinë e Politikave të Vlerësimit Doganor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është bërë në kundërshtim me parashikimet ligjore që kanë të bëjnë me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të gjithë materialin shkruesor që pasqyron veprimet administrative të kryera për transferimin e kësaj nëpunëseje.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr.11, datë 10.2.2020, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në lidhje me transferimin e përkohshëm të nëpunës *****”*, në të cilin është vendosur:

*“1. Të kërkoj nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin administrativ për kthimin e nëpunës ***** në pozicionin e mëparshëm të punës, si “Specialist në Sektorin e Administratës dhe Shërbimit”, Dega Doganore Tiranë, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar...”*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka informuar Komisionerin në rrugë elektronike në datën 19 qershor 2020, në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 11, datë 10.2.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkruese përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Rezulton se, nga ana e institucionit janë marrë masa për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë, duke e kthyer nëpunësen në pozicionin e mëparshëm me aktin nr. 5998 prot., datë 11.3.2020, *“Për rikthim në detyrën e mëparshme”*, në përputhje me detyrën e lënë nga Komisioneri.

Për sa u përket më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë zbatuar detyrat e lëna në Vendimin Nr. 11, datë 10.2.2020, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në lidhje me transferimin e përkohshëm të nëpunës *****”*, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 11, datë 10.2.2020, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në lidhje me transferimin e përkohshëm të nëpunës *****”*.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 11, datë 10.2.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësja
*****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha